

## AKT -THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 20.12.1998, ne baze te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit

### VENDOSI:

Te krijoje shoqerine anonime "Rregjistri Detar Shqiptar" Durres Sh.A.

2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

Klasifikimi i mjeteve lundruese, kontroll i anijeve nga ana teknike nese plotesojne kushtet per te dale ne lundrim dhe sipas gjendjes se tyre dhe pajisjeve te aparaturave qe kane, sipas konventave nderkombetare gjykohet per rajonin e lundrimit, pais anijet me certifikatet e nevojshme per lundrim si me ate te klasit, vijes se ngarkese, tonazhit, navigacionit, paisjeve te shpetimit te jetes ne det te njerezve te radiotelefones, te konstruksionit, mbrojtjes nga ndotjet e ujrave te deteve te transportit te mallrave te rrezikshme, te kalimit te kanaleve dhe te gjitha certifikatat e lundrimit te anijeve sipas I.M.O.S. (Organizates Detare Nderkombetare). Marrja ne rregjister e anijeve qe perfitojne te drejten e klasifikimit nga Rregjistri Detar Shqiptar Durres.

3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres dhe ajo mund te cele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi me miratimin e organeve kopetente edhe jashte shtetit.

4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 7.758.000 leke i ndare ne 7.758 aksione me vlere nominale 1000 leke.

5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.

6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :

1) Mihal BOZDO

2) Arvit URUÇI

3) Rifat MUÇO

7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.

8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.



# STATUT I SHOQERISE ANONIME

## NENI 1 Emertimi dhe selia

Shoqeria anonime krijohet nga transformimi i ndermarrjes shteterore Rregjistri Detar Shqiptar Durres .

Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet Sh.A “Rregjistri Detar Shqiptar” Durres .

Selia e shoqerise eshte ne adrese : Durres

## NENI 2 Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

- Klasifikimi i mjeteve lundruese, kontroll i anijeve nga ana teknike nese plotesojne kushtet per te dale ne lundrim dhe sipas gjendjes se tyre dhe pajisjeve te aparaturave qe kane, sipas konventave nderkombetare gjykohet per rajonin e lundrimit, pais anijet me certifikatet e nevojshme per lundrim si me ate te klasit, vijes se ngarkese, tonazhit, navigacionit, paisjeve te shpetimit te jetes ne det te njerezve te radiotelefonise, te konstruksionit, mbrojtjes nga ndotjet e ujrave te deteve te transportit te mallrave te rrezikshme, te kalimit te kanaleve dhe te gjitha certifikatat e lundimit te anijeve sipas I.M.O.S. (Organizates Detare Nderkombetare). Marrja ne rregjister e anijeve qe perfitojne te drejten e klasifikimit nga Rregjistri Detar Shqiptar Durres.

- Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera jashte vendit.



### **NENI 3**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 7 758 000 leke. Nga ku vlera e truallit eshte 133 248 leke. Numri i aksioneve eshte 7 758. Vlera nominale e aksionit eshte 1000 leke.

### **NENI 4**

#### **Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi**

Transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit do te kryhet me Urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizimin.

### **NENI 5**

#### **Organet drejtuese te shoqerise**

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- 1) Keshilli mbikqyres
- 2) Drejtoria

### **NENI 6**

#### **Keshilli Mbikqyres**

- Keshilli mbikqyres perbehet nga 3 (tre) anetare. Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit.
  - Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte 4 (kater) vjet. Anetaret e keshillit mbikqyres jane te gjithë te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar per shkaqe te perligjura.
  - Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.
  - Ne se nje ose disa vende te anetareve te keshillit mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se 3 (tre) muaj. Anetari i keshillit mbikqyres i emeruar me zevendesim te nje anetari tjeter, perfundon mandatin e paraardhesit..
- Anetaret e keshillit mbikqyres te moshes mbi 65 (gjashtedhete e pese) vjeç nuk mund te jene me shume se 1/3 (nje e treta) e numrit te pergjithshem te keshillit mbikqyres. Ne se ky raport tejkalohet anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.



## NENI 7

### Kryetari dhe zevendes kryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes kryetar, te cilet therresin mbledhjen e keshillin dhe te drejtojne diskutimet. Ata zgjidhen per te gjithë kohen e mandatit te tyre dhe jane te rizgjedhshem.

Keshilli mbikqyres mund te ngarkoje nje person si sekretar edhe jashte anetareve te tij.

Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit, mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga zevendes kryetari.

## NENI 8

### Vendimet e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres mblidhet sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij, te zevendes kryetarit. Kryetari duhet te therrase mbledhjen e keshillit mbikqyres brenda 15 (pesembedhete) diteve kur drejtoria ose 1/3 (nje e treta) e anetareve te keshillit mbikqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete qellim. Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere anetaret mund te therrasin mbledhjen e keshillit mbikqyres, duke i percaktuar rendin e dites. Ne parim thirrja duhet te behet 3 (tre) dite perpara, me leter, telegram, teleks ose fax. Por thirrja mund te jete e vlefshme edhe me goje dhe pa afat ne se anetaret e keshillit mbikqyres do ta pranojne ate. Çdo thirrje duhet te percaktoje rendin e dites.

Mbledhja e keshillit mbikqyres zhvillohet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te percaktuar ne thirrje. Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem vetem ne se jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem, ne rast barazimi votash, ajo e kryetarit eshte percaktuese.

Keshilli mbikqyres mban nje regjister te pjesemarrjes ne mbledhjen e tij, i cili nenshkruhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje. Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen me pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga kryetari ose zevendes kryetari.

Kopjet e vendimeve vertetohen nga kryetari ose zevendes kryetari i keshillit mbikqyres.



## NENI 9

### Kompetencat e keshillit mbikqyres

- Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te perhershëm per administrimin e shoqerise nga drejtoria dhe i jep kesaj te fundit autorizimin per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtoria pa autorizimin e keshillit mbikqyres.
- Keshilli mbikqyres emerone drejtorine. Keshilli mbikqyres cakton njerin prej anetareve te drejtorise me cilesine e drejtorit.
- Me emerimin e anetareve te drejtorise keshilli mbikqyres lidh kontrate me ta per detyrimet qe rrjedhin ne administrimin e shoqerise.
- Keshilli mbikqyres autorizon drejtorine qe te kryeje veprimet dhe te realizoje marreveshjet e parashikuara ne nenet 12 dhe 13 te statutit.
- Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontrole qe ia i çmon te pershtatshme dhe te njihet me dokumentacionin qe i gjykon te nevojshëm per permbushjen e detyres se tij.
- Drejtoria i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten njehere ne tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbyljes se ushtrimit financiar drejtoria duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli.
- Keshilli mbikqyres i propozon Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit lidhur me keto çeshtje :

a) Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate te shoqerise.

b) Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise.


c) Hapjen e veprimtarive ose njesive te reja dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.

d) Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshëm te shoqerise.

e) Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesmarrjen ne kapitalin e shoqerve te tjera.

f) Marrjen e huave afatmesme, afatgjate.

g) Si dhe per çdo çeshtje tjeter qe ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare" eshte kompetence e Asamblese se Pergjithshme.



## **NENI 10**

### **Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres**

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara me Vendim te Keshillit te Ministrave.

## **NENI 11**

### **Drejtoria**

- Shoqeria administrohet nga drejtoria e cila mund te perbehet nga nje ose disa anetare. Numri i anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres me nje vendim te tij.
- Drejtoria emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakord jo me pak se 2/3 (dy te tretat) e te gjitha anetareve te ketij keshilli.
- Anetaret e drejtorise jane persona fizike, ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshem. Ata mund te zgjidhen dhe jashte te punesuarve ne shoqeri. Nese nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet anetar i drejtorise mandati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet anetar drejtores ose drejtor ne me shume se nje shoqeri. Anetaret e drejtorise mund te shkarkohen nga keshilli mbikqyres per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga funksioni i anetarit te drejtorise nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates.
- Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe kohe prej 4 (kater) vjetesh. Ne rastet e pushimeve dhe mungesave te zgjatura, keshilli mbikqyres ben zevendesimin e tyre.
- Anetaret e drejtorise jane te riemerueshem, ata nuk mund te jene mbi moshen 65 (gjashtedhete e pese) vjeç. Anetari i drejtorise qe mbush moshen 65 (gjashtedhete e pese) vjeç konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.
- Paga e anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tyre.

## **NENI 12**

### **Kompetencat e drejtorise**

- Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te shoqerise.



- Ne marrëdhëniet me të tretet shoqëria merr përsipër detyrime që rrjedhin nga aktet e drejtorisë të nënshkruara nga anëtari me cilesinë e drejtorit edhe kur këto e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretet e dinin që akti i drejtorisë kapërcente objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretet nuk mund të injorin këto akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është prove e mjaftueshme.
- Aktet me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tremeve duhet të nënshkruhen nga anëtari me cilesinë e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.
- Drejtoria merr vendim me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm kur janë prezent jo më pak se gjysma e anëtarëve të sajë. Në rast barazimi votash, vota e anëtarit të caktuar me cilesinë e drejtorit është përcaktuese.
- Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet dhe me vlerë mbi 2 (dy) milion leke bëhet me autorizim të keshillit mbikqyres.
- Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore që miratohet nga keshilli mbikqyres.
- Drejtoria bën strukturën e organizimit të shoqërisë të cilën e miraton keshilli mbikqyres.

### **NENI 13**

#### **Marreveshjet ndërmjet shoqërisë dhe drejtorisë ose të një anëtari të keshillit mbikqyres**

Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe anëtarëve të drejtorisë ose një anëtari të keshillit mbikqyres, qoftë e drejtepërdrejtë ose jo e drejtepërdrejtë duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak të keshillit mbikqyres.

Përcaktimi i mesipërme është i vlefshëm edhe për marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe një shoqërie tjetër, kur një anëtar i keshillit mbikqyres është edhe anëtar i keshillit mbikqyres të një shoqërie tjetër, me të cilën propozohet të lidhet marrëveshje. Kjo nuk është e zbatueshme për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë rrjedhese të shoqërisë që kryhen në kushte normale.

Anëtari i drejtorisë ose i keshillit mbikqyres i interesuar duhet të njoftojë keshillin mbikqyres për një marrëveshje për të cilën zbatohet kërkesat e këtij neni të statutit. Anëtari i interesuar i keshillit mbikqyres nuk merr pjesë në votimin për dënimin e autorizimit.



**NENI 14**  
**Eksperti kontabel i autorizuar**

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga 1 ( nje ) eksperte kontabel te autorizuar, te cilet emerohen nga aksionmbajtesi i vetem dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

**NENI 15**  
**Ushtrimi financiar**

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohën nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar deri me 31 Dhjetor.

**NENI 16**  
**Inventari -llogarite vjetore**

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitetit te rregullt te pasurise dhe te vperimtarise se saj ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbylljen te ushtrimit, drjtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar. Drejtoria pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar.

**NENI 17**  
**Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i fitimit**

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem. Nga fitimet e ushtrimit, te paksuara kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 % (pese perqind) per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte detyrueshme kur kjo rezerve arrin 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon per nje arsye çfaredo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 1/10 (nje te dhjetat) e kapitalit. Perdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit.



## **NENI 18**

### **Emerimi i anetareve te pare te keshillit mbikqyres**

1. Si anetare te pare te keshillit mbikqyres emerohen:

2) Mihal BOZDO

3) Arvit URUÇI

3) Rifat MUÇO

## **NENI 19**

### **Emerimi i ekspertit kontabel te pare te autorizuar**

Ekspert i (te) pare kontabel i (te) autorizuar emerohet (n)

1) Znj. Nadire Hyseni

## **NENI 20**

### **Asambleja e pergjithshme**

Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga ligji Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" qe nuk jane shprehur ne kete statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit me cilesine aksionerit te vetem.

## **NENI 21**

### **Dispozita te fundit**

Ne nje afat prej 6 (gjashte) muajsh nga data e rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregtar, drejtori i shoqerise do te jete drejtori i ish-ndermarrjes shteterore. Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit veç per shkaqe te perligjura.

## **NENI 22**

Per çfare nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

20.12.1998

